



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:262406

Datë: 09.01.2025

Numri i dokumentit: 06777972

**2024:298162**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me bashkëpunëtorin profesional Shkelzen Polloviqi, në çështjen penale kundër të pandehurve A.F., për shkak të kryerjes së veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe A.J. për shkak të kryerjes së veprës penale Moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre nga neni 378 par. 1 nën par. 1.9 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm PP.II.nr.1343/24, të dt.18.10.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Gazmend Salihu, të pandehurit A.F. dhe mbrojtësit me autorizim av. Arbër Jashari me autorizim zëvendësues të Av.Naim Ferati, dhe të pandehurit A.J. e mbrojtësi i tij me autorizim av. Bekim Ademi, më datë 12.12.2024, ka mbajtur seancë për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe po këtë ditë mori dhe publikisht komunikoi, ndërsa më datë 09.01.2025, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

Të pandehurit:

1. A.F., nga i ati Ilir, e ëma E., e vajzërisë P., i lindur më ....., në ....., me vendbanim në .... rruga "...." kati .. (banesat e ....), me numër personal ....., i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, pronar i kompanisë "....", i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar më parë për vepër penale, ndaj tij udhëhiqen procedura tjera penale.

2. A.J., nga i ati I., e ëma N., e vajzërisë F., i lindur më ....., në ....., me vendbanim në .. rruga ”.....” ndërtesa përball .... së qytetit, kati ., nr.. , me numër personal ....., i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer fakultetin ekonomik, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë për veprë penale, ndaj tij nuk udhëhiqen procedura tjera penale.

## JANË FAJTOR

### I pandehuri i parë

Sepse prej datës së pavërtetuar e deri më datën 20.08.2024, në ....., në rrugën “... ..”, saktësisht tek zyrat e kompanisë “.....”, i pandehuri njëkohësisht edhe pronar i kompanisë, në kundërshtim me Ligjin e aplikueshëm për armët të Republikës së Kosovës Nr. 05/L-022, ka mbajtur në pronësi dhe posedim pa leje dhe pa autorizim një granatë dore, e llojit M-75, me ngjyrë të zezë, e cila armë është sekuestruar përkohësisht nga ana e policisë si provë materiale.

Me çka ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.(KPRK-së).

### I pandehuri dytë

Sepse prej datës së pavërtetuar e deri më datën 20.08.2024, në ....., në rrugën “.....”, saktësisht në zyrat e kompanisë “.....”, i pandehuri në cilësinë e menaxherit, duke qenë në dijeni për identitetin e të pandehurit A.F. si kryerës i veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, par.1 të KPRK-së, si në pikën I të këtij dispozitivi, në atë mënyrë që pasi gjen mjetin e pashpërthyer granatë dore e llojit ....., ngjyrë e zeze të mbështjellur me qese të bardhe dhe e mbyllur në njërin nga zyrat e kompanisë, të njëjtën e merr dhe e fut në një zyrë tjetër në sefë (dollap) të mbyllur me çelës dhe kodë, në të cilën ka pasur qasje edhe pronari i kompanisë, i pandehuri A.F. dhe nuk e lajmëron faktin e tillë.

Me çka ka kryer veprën penale Moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre nga neni 378 par.1, nënpar.1.9 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, (KPRK-së).

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe nenit 366 dhe 378 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe neneve 364 dhe 452 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të pandehurit i :

## **G J Y K O N**

### **Të pandehurin e parë**

Me dënim me gjobë, në shumë prej 700 /shtatëqind / Euro.

### **Të pandehurin e dytë**

Me dënim me gjobë, në shumë prej 500 /pesëqind / Euro.

Dënimet e shqiptuara me gjobë të pandehurit janë të obliguar ti paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se të pandehurit nuk i paguajnë dënimet me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPK-së, të njëjtëve dënimet do t'i shndërrohen, në dënime me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'iu llogaritet nga një (1) ditë burgim.

Obligohen që të pandehurit që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajnë në mënyrë solidare shumën prej 60 Euro (gjashtëdhjetë euro), si konform 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për kompensimin e viktimave të shumën secili veç e veç prej nga 20 /njëzet/ Euro, që të dyja shumat brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Konform nenit 366 par. 3 KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme një (1) granatë dore e llojit ....., ngjyrë e zezë.

## **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.1343/24, e dt.18.10.2024, ndaj të pandehurit të parë për shkak të kryerjes së veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, ndërsa për të pandehurit të dytë për shkak të kryerjes së veprës penale Moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre nga neni 378 par. 1 nën par. 1.9 të KPRK-së dhe aktakuzës i ka bashkangjitur marrëveshjet për pranimin e fajësisë PP/II.nr.1343/24, të datave 04.10.2024 dhe 08.10.2024, deklaratat e të pandehurve të dt.08.10.2024 dhe e dt.04.10.2024, të nënshkruara nga ana e të pandehurit A.F. dhe mbrojtësit të tij me autorizim av. Naim Ferati dhe të pandehurit A.J. dhe mbrojtësit të tij me autorizim av. Bekim Ademi, Prokurorit të Shtetit Gazmend Salihu

dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore Ferizaj Shukri Jashari, ku është arritur marrëveshja për pranimin e fajësisë, për veprat penale Mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar nga neni 366, paragrafi 1 i KPRK-së dhe Moslajmërimi i veprës penale apo kryerësve të tyre nga neni 378, par.1, nënpar.1.9 të KPRK-së, dhe është rekomanduar për të pandehurin e parë, dënim me gjobë në shumë prej 700 € (shtatëqind) Euro) dhe të bëhet konfiskimi në mënyrë të përhershme të sendeve të sekuestruara dhe atë granatë dore e llojit M-75, ngjyrë e zezë, kurse për të pandehurin e dytë dënim me gjobë në shumë prej 500 € (pesëqind) Euro).

Gjykata duke vepruar sipas akuzës, me datë 12.12.2024, ka mbajtur seancën për shqyrtimin e marrëveshjes për pranim të fajësisë, të arritur me datat dt.08.10.2024 dhe e dt.04.10.2024, në të cilën të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre dhe prokurori i shtetit janë deklaruar përkitazi me marrëveshjen për pranimin e fajësisë duke i propozuar gjykatës pranimin e kësaj marrëveshje sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e tyre.

Gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, gjykata konstatoi se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara sipas dispozitës së nenit 230 par.17 të KPRK-së, se:

- Të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë.
- Pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve është bërë vullnetarisht dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre dhe se të pandehurit nuk kanë qenë të detyruar e as të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë.

Pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza dhe materialet e prezantuara siç janë: Raporti fillestar i incidentit i dt.20.08.2024, Raporti i oficerit i dt. 20.08.2024, deklaratat e të pandehurit A.F., të dhëna si para hetuesve policor në SP – Ferizaj, më datë 20.08.2024, ashtu edhe para prokurorit të shtetit më datë 23.09.2024 dhe 08.10.2024, deklaratat e të pandehurit A.J., të dhëna si para hetuesve policor në SP – Ferizaj, më datë 20.08.2024, ashtu edhe para prokurorit të shtetit më datë 23.09.2024, deklarata e të dyshuarit B. F. e dhënë në SP Ferizaj me dt.20.08.2024, deklarata e të dëmtuarit A. F. e dhënë në polici me dt.20.08.2024, procesverbalet për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm, vërtetimi për sekuestrim të përkohshëm të sendeve i dt.20.08.2024, së bashku me formularin e dëshmimeve.

Si dhe gjykata ka konstatuar se nuk ekziston asnjë rrethanë e paraparë nga nenin 248 paragrafët 1 dhe 2. të këtij Kodi.

Andaj gjykata pranon marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe bazuar në këtë marrëveshje vazhdoi me shqiptimin e dënimit për të pandehurit.

Gjykata duke vepruar në aspektin juridik gjeti se në veprimet e të pandehurve, ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të kryerjes së veprave penale Mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar nga neni 366 paragrafi 1 i KPRK-së dhe Moslajmërimi i veprës penale apo kryerësve të tyre nga neni 378 par.1, nënpar.1.9 të KPRK-së ashtu siç është theksuar edhe në dispozitive të këtij aktgjykimi, në të cilat është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra e kryerjes së veprave penale.

Me rastin e matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së dhe si rrethana lehtësuese për të pandehurit morri se kanë arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë me Prokurorin, se ndaj tyre për momentin nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër për ndonjë vepër penale, se i pandehuri i dytë nuk ka dëshmi se më parë të ketë qenë i dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, ndërsa si rrethanë rënduese gjeti se i pandehuri i parë sipas deklarimit të tij ka qenë i dënuar edhe më parë për vepër penale posedimi paautorizuar i narkotikëve, gjykata përveç atyre që u thanë më lartë, vlerësoi edhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurve dhe rrezikshmërinë konkrete të veprave penale dhe duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprave penale, gjykata në këtë rast beson që edhe me dënimet e shqiptuara do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i përcaktuar me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së, në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale dhe dënimet e tilla janë adekuate dhe në proporcion të drejtë e në raport me peshën e veprave penale, rrethanave të kryerjes së veprave penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe me personalitetin e të pandehurve.

Vendimi mbi konfiskim është marrë, në kuptim të nenit 366 par.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle, është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 par. 1 të KPPRK-së, ndërsa vendimi mbi kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par. 3 pika 3.2 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit Nr. 08/L-109.

Në bazë të theksuarave më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ,**  
**DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**

**2024:298162, e datës 09.01.2025**

**Bashkëpunëtori profesional**  
**Shkelzen Polloviqi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Imri Sejda**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.